

KULTURA ROMAKE NË QYTETET ANTIKE TË BUTHROTIT DHE TË FOINIKES THE INFLUENCE OF ANCIENT ROMAN CITIES BUTHROTI AND FOINIKE

KLODIAN GJONI

Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare,
Sarandë, Shqipëria
e-mail: klodgjon@yahoo.com

AKTET VI, 5: 521-527, 2013

PËRMBLEDHJE

Objekti i këtij studimi është ndikimi romak në qytetet antike të Buthrotit dhe Foinikes të fisit Kaon, sepse këto dy qytete dhe krahinat përreth i kanë ndierë që herët synimet kolonizuese të Romës. Synohet të evidentohet prania e elementit romak si në objektet arkeologjike (qeramikë, mbishkrime, monedha) e në arkitekturë (teatrot, tempujt, vilat), ashtu edhe në organizimin shoqëror dhe administrativ. Shpjegohet dhe argumentohet prania e emrave romakë, si: Aulus, Markus, Lucius të gjetura në mbishkrimet e Butrintit, në Foinike ose në portin e Onhezmit. Elementi romak ka qenë i pranishëm në disa aspekte në qytetet antike të Buthrotit dhe Foinikes dhe ka ndikuar në zhvillimin kulturor e historik të tyre duke i ruajtur gjurmët e tyre deri sot, por pa mundur të asimilojë popullsinë e kulturën vendase. Sillen fakte e të dhëna nga autorët antikë që tregojnë se që nga shek I para Kr., derisa ai gëzonte të drejtat e qytetarisë vendosja e qytetarëve romakë në Butrint duhet të jenë shpeshuar. Argumentohet se gjatë luftave civile, Butrinti ishte baza e furnizimeve për Çezarin. Augusti vendos në Butrint një koloni të re veteranësh e civilësh, që dëshmohet nga monedhat e gjetura këtu. Ndikimet romake në Foinike dëshmohen kryesisht në qeramikë, në prodhimin e tullave dhe të tjegullave. Gjurmë të periudhës romake dëshmohen edhe: në banesën me dy peristile, Nekropol, Teatrin e Finiqit, Bazilikën në Akropol, Baptisterin, Piedestalin e Neronit, Murin rrethues, dy sterat.

Fjalë Kyçe: ndikimi romak, qytete antike, Buthrot, Foinike, objekte arkeologjike, kaon.

SUMMARY

The object of this study is the influence of ancient Roman cities of the tribe Foinike Buthrotit and kaon. Intended to be recorded as the presence of the Roman element in archaeological objects (pottery, inscriptions, coins), architecture (theaters, temples, villas) and in social and administrative organization. The explanation is the presence of Roman names: Aulus, Marcus, Lucius inscriptions found in Butrint, in Foinike or Onhezmi port. This indicates that traders italics in Butrint have participated with the local population in the cult of Asclepius and the acts of the release, which are among the most important archaeological objects. Distinguish the effects of traces from the Roman period: the apartment with two peristyle, Necropolis, Finiqi Theatre, the Acropolis Basilica, Baptistery, pedestal of Nero, the surrounding wall, two mainland. Paper brings contributions to historical research, archaeological ancient settlements in Albania.

Key words: Roman influence, ancient cities, Buthrot, Foinike, kaon.

1. Hyrje

Objekti i këtij studimi është ndikimi romak në qytetet antike të Buthrotit dhe Foinikes të fisit Kaon. Këto dy qytete dhe krahinat përreth i kanë ndierë që herët synimet kolonizuese të Romës.

Prania e tregëtarëve italikë në këto zona ka nisur që nga viti 230 para Kr. dhe është dëshmuar që prej Polibit, ndërsa zhvillimi i protektoratit pas Luftës së Parë iliro-romake, i përforcoi këto kontakte shkëmbimesh të cilat ndikuan në çdo

aspekt të jetës duke sjellë ndikime në zhvillimin kulturor e historik të tyre duke i ruajtur gjurmët deri më sot.

Kaonia ishte një vend bregdetar me një klimë të mirë e ujëra të bollshme, krahinë e dëgjuar për limanet e shumta, për kullotat e pasura, kuajt dhe tufat e mëdha të bagëtive të imëta. Ishte e pasur si në bujqësi e blegtori, pa përrjashtuar dhe peshkimin si mjet i domosdoshëm jetese. Kaonisë i përkisnin një varg qytetesh antike të lulëzuara si: Buthroti, Foinike, Onhezmi, Antigonea, Sopotit e Himara. Pindari thotë: “Epiri (ku përfshihet dhe Kaonia) shtrihet që larg, ku kodrat e veshura me kullota zbresin nga Dodona deri në detin Jon.” (Pindari te Hodges 2006: 18).

Kaonia duke qenë një krahinë e dëgjuar nuk ngeli pa u spikatur nga romakët që herët. I pari që ndjeu synimet kolonizuese të Romës, ishte qyteti antik i Buthrotit me rrethina. Prania e tregëtarëve italikë në këto zona nis që nga viti 230 para Kr. dhe është dëshmuar nga Polibi, ndërsa zhvillimi i protektoratit pas Luftës së Parë Iliro-Romake, i përforcoi këto kontakte shkëmbimesh (Cabani 1974: 208). Kontaktet tregtare të zonës rreth Butrintit me gadishullin Italik, Kabani i shpjegon me praninë e emrave romakë si: Aulus, Markus, Lucius (Cabani 1974: 208). Sipas Polibit tregtarët italikë që vinin në këto zona nuk ishin të paktë. Ata vihen në dukje prej tij në përshkrimin e fushatës së ilirëve për pushtimin e kryeqytetit të Epirit, Foinikes (Polyb II, 8, 2-3).

Në luftën e dytë maqedono-romake Epiri, ku përfshiheshin dhe kaonët, u përpoq të ruante asnjësinë midis Maqedonisë dhe Romës dhe të ndërmjetësonte rishitas në vitin 198 para Kr. për një paqe midis tyre, po kësaj radhe pa dobi, meqënëse kërkesat romake qenë të rënda për Filipin V. Në këtë kohë te një pjesë epirote filluan të shfaqeshin tendencat e para për të përkrahur Romën. Vetëm qytetit të Foinikes, bashkë me një territor të vogël të banuar nga kaonët, romakët i lanë një farë autonomie.

2. Ndikimi romak në qytetin antik të Buthrotit në organizimin shoqëror dhe administrativ

Që në vitin 167 para Kr. Epiri (ku përfshihej Kaonia) dhe një pjesë e Thesprotisë ishin dalluar

si përkrahës të Romës kundër Perseut të Maqedonisë. 10 vjet më vonë nga Kaonia shkëputet krejtësisht territori i prasaibëve me qendër Butrintin. Romakët i nxitën prirjet autonomiste të prasaibëve deri në dhënien e statusit të një koinoni të pavarur rreth vitit 157 para Kr..

Në këto kushte për të siguruar ekuilibrin e dëshiruar, romakët duhet të kenë qenë të interesuar për forcimin e koinonit të prasaibëve, sidomos për sa i përket fuqisë mbrojtëse të saj. Kjo ishte një pavarësi formale. Ende më formale u bë pavarësia e prasaibëve pas vitit 148 para Kr., kur krejt Epiri u përfshi në provincën maqedone. Megjithatë, prasaibët, siç tregojnë mbishkrimet e reja të zbuluara në Butrint, e ruajtën organizimin e tyre të veçantë së paku deri në vitin 100 para Kr..

Titulli Koinon i Epiriotëve, që evokon pozitën sunduese të dikurshme të molosëve, është sugjeruar nga diplomacia romake në përputhje me politikën e saj përcarëse dhe të ruajtjes së ekuilibrit. Butrinti dhe zona rreth tij ka jetuar të njëjtat shqetësime dhe pasiguri si dhe krejt Epiri, të kushtëzuara nga pleksja e interesave të fuqive të mëdha të kohës si shteti ilir, maqedon dhe ai romak.

Butrintit, siç mund të gjykohet nga ndërtimet mbrojtëse, i është dashur të përballojë dhe synimet e fqinjëve më të afërt që para vitit 157 para Kr. dhe veçanërisht pas kësaj date. Kjo situatë komplekse pasqyrohet, deri diku dhe në ndërtimet mbrojtëse të qytetit, në fazat e ndryshme të ndërtimit, në prishjen apo në rindërtimin e mureve, si dhe në zgjerimin apo ngushtimin sipas rastit të territorit të fortifikuar të qytetit.

Në Jug Roma krijoi një zotërim të vetin. Ka të ngjarë që në këtë periudhë Kaonia të jetë konsideruar si aleat a mik që i lejohej e drejta e një vetadministrimi të kufizuar, por në fakt ishte e varur nga Roma dhe si e tillë nuk mund të hynte në marrëdhënie të lira me shtetet e tjera. Pas kësaj Kaonia ishte e detyruar të pranonte, në çdo kohë ushtritë romake dhe t'i furnizonte me ushqime, apo t'i plotësonin me kontigjente ndihmëse tokësore e detare.

Gjatë periudhës së luftimeve civile Butrinti ishte baza e furnizimeve për Çezarin. Ky i fundit në veprën e tij *Luftrat civile* shkruan se “ishte ngushtë me ushqime, pasi këto ndodheshin në Buthrot” (Caes 40: 16). Por duke menduar se lufta me Pompeun do të zgjatej dhe duke humbur shpresën për të marrë furnizime nga Italia, Çezari dërgoi dy komandantët e tij në Buthrot për të marrë drithëra (Caes 40: 4).

2.1. Gjendja e Buthrotit nën sundimin romak

Gjatë sundimit romak në Buthrot u vendosën qytetarë romakë e u shndërruan në koloni. Në shekujt e parë të këtij sundimi, ky qytet pati një lulëzim që pasqyrohej dhe në prerjen e monedhave autonome prej bronzi. Tokat dhe kullotat më të mira ranë në duart e pronarëve të mëdhenj romakë. Pikërisht pranë Butrintit kishte pronat e vilën e tij romaku i njohur, latifondisti i madh, miku i ngushtë i Ciceronit, Pompon Atiku që jetoi në kohën e Perandorit Oktavian Augusti.

Që nga shek I para Kr. vendosja e qytetarëve romakë në Butrint duhet të jetë shpeshtuar, derisa ai gëzonte të drejtat e qytetarisë, së paku, që para mesit të këtij shekulli. Ciceroni në Ad. Atikum 1 5-6 thekson: “Në kohën kur Pompon Atiku banonte në rrethet e Butrintit, Butrinti gëzonte të drejtat e municipit”.

Në këtë kohë Butrinti kishte rëndësi të veçantë strategjike, si bazë detare për zotërimin e Korfuzit. Rëndësia e Butrintit del në dukje dhe nga fjalët e Ciceronit drejtuar Atikut. Letrat e Ciceronit drejtuar Atikut e tregojnë këtë dhe përbëjnë një depërtim magjepsës, në kohën kur Butrinti, qoftë dhe për një periudhë të shkurtër, luajti një rol të rëndësishëm në skenën e politikës romake. “Më ler të të them se Butrinti është për Korkyrën (Korfuzin), ashtu siç është Antiumi për Romën – vendi më i qetë, më i këndshëm dhe më i bukur në botë” (Letër e Ciceronit drejtuar Atikut 4.8.1. viti 56 para Krishtit).

Në vitet e fundit të jetës së Çezarit vendosen në Butrint kolonët ushtarakë (veteranët). Atiku shqetësohet për ndarjen e tokave veteranëve dhe, me gjithë kundërshtimet e ndërhyrjet, nuk mundi të ndalohej vendosja e tyre. Ka pasur njëkohësisht karakter ushtarak dhe agrar, gjë që

kuptohet nga mënyra e vendosjes së kolonëve dhe që ka të bëjë me qëndresën që gjetën pushtuesit te popullsia vendase dhe te kushtet e mira për zhvillimin e bujqësisë (Anamali 1976: 43).

Shkrimtarët e lashtësisë kanë përmendur mjaft edhe peshkun, edhe shpezët e gjahut të Kaonisë, sidomos në rrethinat e Butrintit. Butrinti ishte famëmadh dhe për gjuetinë që zhvillohej aty (Hodges 2006: 18).

Në Kaoni kishte dhe një racë të veçantë të qenve të gjuetisë dhe të qenve të stanit (Ceka 1998: 276-277). Qendra blegtorale më e përmendur e Epirit ishte krahina e Kestrisë (fusha e Vrinës) pranë Butrintit.

Straboni e përshkruan portin e Butrintit si Pelades Limes ose Port të përbaltur. Është e paqartë nëse ai e pati vizituar apo jo qytetin. Ka të ngjarë që gjeografi kishte dëgjuar prej tregtarëve apo shtegtarëve, të cilët kujtonin me hidhërim ujërat e turbullta në kanalin e Vivarit. Balta duhet t'i ketë rënë në sy çdo vizitori që mbërriti në Butrint në shek. II ose I p. K.. Kur Jul Çezari vizitoi Butrintin rreth vitit 48 p. K. dhe zbriti nga anija duke u ulur poshtë bregut, këmba e tij do të ketë shkëlur në rripin e terrenit me baltë, më në lindje të faltores së famshme të shërimit.

Mund ta marrim me mend gjykimin e tij lakmitar: Butrinti kishte të gjitha kushtet për të shfrytëzuar rritjen e sundimit ekonomik romak në rajon dhe për të investuar për një ripërtëritje urbane madhore duke i dhënë një zhvillim të gjerë prodhimeve bujqësore. Tri monedha të vogla bronzi që paraqiten sot të gërryera, të prera në Butrint rreth viteve 44-31 p. K. nga dy magjistratë romakë të qytetit (P. Dastidius dhe L. Cornelius) tregojnë se plani i Çezarit ishte vënë në zbatim (Hodges 2006: 84).



Augusti çoi në Butrint një koloni të re veteranësh e civilësh, gjë që kuptohet nga legjenda e monedhave romake të Butrintit “Colonia Augusta Buthrotum” (Mustilli 1940: 6.), si dhe nga që kolonia mbante dy emra “Colonia Julia Augusta Buthrotum” (Anamali 1976: 44).

Tokat pjellore rreth Butrintit, blegtoria që favorizohej nga kushtet e mira klimaterike, peshkimi dhe tregtia, i dhanë një zhvillim të dukshëm qytetit në shekujt e parë të erës sonë.

2.2. Gjetjet arkeologjike me ndikim romak

Pushtuesit romakë për nevojat e tyre bënë ndërtime të shumta, të cilat në disa raste ndryshuan planet e vjetra urbanistike të qyteteve sidomos në Buthrot e Foinike. Në qytete e në zona fshatare deri në thellësi hyjnë në përdorim tjegulla solene e kaliptere, të lakuara, tulla me trajta e përmasa të ndryshme, ndërsa në ndërtim hyn llaçi e gëlqerja, të cilat sollën ndryshim në teknikën e ndërtimit, në cilësinë dhe në pamjen e godinave dhe që janë të ndikuara nga stili romak. Monumentet më të theksuara në Buthrot janë: Akropoli i Butrintit, Porta me kulla, Kulla e mbishkrimeve, skena e teatrit, banja e Vivarit, tempulli i Asklepit, banesa me Atrium, figurat e bronzit, monedhat, ujësjellësi.

(a) Ndër objektet me ndikimin më të madh romak përmendim: Akropoli i Butrintit ka njohur disa periudha fortifikimesh. Evidente është edhe ajo e periudhës romake. Sipas analizave të materialit arkeologjik, mendohet se është e kohës kur Çezari e bëri Butrintin bazë të operacioneve të tij kundër Pompeut. Elementët romakë janë disa trakte muresh në akropol dhe pranë portës Skea. Ato dallohen nga teknika opus quadratum me blloqe të vogla katërkëndëshe të lidhura me llaç gëlqereje.

(b) Kohës së hershme të kolonisë romake të krijuar nga Augusti, i takon një mur ndërmjet Portës me Kulla dhe Kullës së Mbishkrimeve. Në faqen e brendshme të këtij muri janë ndërtuar një varg abjentesh të njëllajta që shërbenin si gazerme për ushtarët (Ceka 2002: 78, 79).

(c) Po në shek. I pas Kr. u rindërtua skena e teatrit sipas stilit romak, e cila pati dhe një fazë të mëvonshme ndërtimi. U shtuan edhe dy galeri në

të dy anët e shkallares për të lehtësuar lëvizjen e spektatorëve për në vendet e tyre, sipas sistemit romak. Galeria perëndimore zgjerohej mbi qemerin e tempullit të Esklapit, të rindërtuar në të njëjtën periudhë. Ndërsa ajo lindore, komunikonte edhe me një shkallë që dilte në paradysin e teatrit. Orkestra në formën e treçerekrrerthit, në periudhën romake është veshur me pllaka.

(ç) Banja romake pranë Vivarit është ndërtim i periudhës romake i shek. II pas K. Dhe ka të gjitha elementët arkitekturorë të stilit romak si: tepidariumi i mbuluar me kube, kthina me qendër të thelluar në formë tetëkëndëshi ku ulen klientët, salla e zbuluar pjesërisht, me dysheme të shtruar me mozaik me motive gjeometrike që cilësohet si sallë zhveshjeje.

(d) Edhe tempulli i Asklepit është ndërtuar në shek II pas Kr., pra në periudhën romake, mbi një



model më të hershëm.

(dh) Edhe banesa me Atrium është e periudhës romake dhe daton në shek. II

pas K. dhe pati përdorim deri në shek. IV. Qendërën e saj e përbënte oborri katror, rrethuar me një peristil prej 12 kolonash. Pjesa perëndimore e oborrit kufizohej me një radhë kthinash me funksion shërbimi. Të bie në sy një kthinë e ndarë simetrikisht në dy pjesë në një mënyrë që mund të ishte një faltore e vogël, kushtuar një kulti të dyfishtë siç ishte ai i Kastorëve. Këndi jugperëndimor i ndërtesës është veçuar në një periudhë të dytë për t'iu aneksuar teatrit me të cilin lidhet përmes një palë shkallësh. Vendosija në kompleksin e teatrit dhe të Asklepionit, mund ta cilësojë ndërtesën edhe si një hotel publik në raste festash për të ftuarit, ose aktorët.

Të shumta janë ndërtimet e tjera shoqërore si banjat publike, faltorja e Minervës, Gjimnazi që ndodhet pranë Portës me kulla, banja pranë Baptistërit.

(e) Po kështu ka ndodhur në relievin, sidomos atë mortor, ku u skalitën relieve me një dekoracion

uniform e monoton, të marrë nga repertori i stileve romake. Në plastikën e vogël vendin kryesor e zenë figurat prej bronzi, të gjetura në Butrint dhe në rrethinat e tij. E tillë është figura e Panit, e gjetur në malin e Spilesë afër Buthrotit. Në këto figura bronzi të vogla, të prodhuara më të shumtën në seri, lidhen me hyjni, ashtu dhe me personazhe laike (aktorë, fëmijë, atletë). Ka dhe modele me vlera të vërteta artistike.

(ë) Për herë të parë në historinë e vet Butrinti preu monedha bronzi në kohën e Augustit. Në njërën nga monedhat paraqitet portreti i perandorit me legjendën "Buth" (rotum) Augustus, ndërsa në shpinë një ujësjellës dhe emri i kryetarit të qytetit T. Pompon Juli II V 12 (duumviz) (Ugolini 1942: 52). Se sa rëndësi pati ky objekt për qytetin, kjo kuptohet nga monedhat që preu Butrinti, në shpinë të të cilave paraqitet ky ujësjellës.

(f) Për furnizimin e qytetit me ujë të pijshëm u ndërtua një ujësjellës me gjatësi 3 km sipas modeleve romake (Budina 1967: 145). Ujësjellësi u ndërtua në kohën e sundimit të Augustit në fillim të shek. I pas Kr..

Në përgjithësi, duhet thënë se në shek. I pas Kr., në qytet u ndërtuan mjaft dhe se ndërtesat shtriheshin deri në rrëzë të kanalit të Vivarit. Shtresa kulturore e shek. IV pas Kr. tregon për një rritje të dendësisë së banimit, ndërsa numri i madh i monedhave tregon për një zhvillim të madh të tregëtisë (Lako 1977- 1978: 295).

Me gjithë vendosjen e kolonëve romakë në Butrint, gjuha latine nuk u bë asnjëherë gjuhë e vetme zyrtare dhe aq më pak gjuhë e folur, gjë që tregon se kolonistët nuk mundën ta asimulojnë popullsinë autoktone. Përkundrazi, në shekujt që pasuan u asimiluan vetë nga popullsia vendase (Anamali 1976: 47).

4. Ndikimi romak në qytetin antik Foinike

Roma e pushtoi gjithë Ilirinë e Epirin. Katastrofën më të madhe në Epir e solli konsulli Luc Emil Paulus dhe gjenerali Anikio më 168 para Kr.. Dëshmitë burimore flasin se kaonët ishin ndarë në provinca që të mos bashkoheshin kundër pushtuesve romakë. Tokat e Kaonisë e të fiseve të tjera në jug ishin shpallur toka perandorake,

ç'ka nënkupton se kishte ende një gjendje të pasigurisë në këtë rajon (Lukiani 2007: 260).

Për të fshehur qëllimet e vërteta të pushtimit, Roma e paraqiti veten si çlirimtare dhe shpalli në mënyrë solemne "lirinë e popujve të Maqedonisë dhe të Ilirisë", por ajo vendosi një regjim të egër ushtarak. Autonomi u dha vetëm Foinikes me rrethinat e tij, ashtu siç kishte vepruar me Dyrrahun dhe Apolloninë (Dede 1978: 16).

Foiniken e gjejmë të vendosur në një mjedis të pasur me toka buke e kullota, vreshtari, kopshtari që formonin bazën ekonomike të qytetit. Në disa raste, siç tregojnë të dhënat arkeologjike, në të zhvillohej edhe një veprimtari e kufizuar zejtare. Rreth tij gjendeshin vendbanime të hapura fshatare, me të cilat formonin një njësi të caktuar ekonomiko-shoqërore. Pra qyteti kishte pamjen e qendrës protourbane.

Monedhat e gjetura në gërmimet arkeologjike në këtë territor flasin për një qendër të madhe zejtare, bujqësore dhe tregëtare, e lidhur me zonat mesdhetare dhe perëndimore. Vlen të përmendet një përcaktim i Ciceronit se "limani që shërbente për të lidhur Finiqin me Korkyrën quhej Onhezmi. Kjo ishte pikë tranziti midis Ilirisë dhe Italisë".

Mënyra antike e prodhimit në Foinike filloi të kishte ndikimet romake dhe i dha një hov të



menjëhershë m prodhimit zejtar dhe sidomos atyre degëve që lidheshin me ndërtimet.

Me forma e teknika të reja paraqiten edhe qeramika, duke përfshirë edhe qeramikën e ndërtimit. Përveç punishteve të poçarisë vendase që prodhonin forma enësh të zakonshme, një përhapje të gjerë mori qeramika e quajtur "terra sigillata", sipas modeleve romake.

Në Foinike u zhvillua arkitektura zyrtare, skulptura, sidomos portreti, arti i mozaikut dhe piktura murale. Por në veçanti ndikim të madh nga arti romak, pati arti plastik, skulptura. Këto i mbetën besnik traditave të artit klasik e helenistik, ose riprodhuan veprat më të njohura

të artit grek, kurse në portretet shpesh janë zbatuar rregullat kompozicionale dhe të skalitjes karakteristike për skulpturën romake.



Ekzistenca e shkollës së skulpturës në Foinike e ndikuar nga shkolla romake, ka ndihmuar shumë dhe për punimet në pikturë e zbukurimet e pajisjeve të përditshme (veçohen enët e kuzhinës si: pjata, gota, shishe, amfora e ornamente të ndryshme).

Krahas me futjen në prodhim të një sërë veglash të reja pune gjatë shekujve të parë të pushtimit romak, hyjnë në përdorim edhe stoli të reja, një pjesë e të cilave lidheshin me modele veshjesh të ardhura.

Zhvillim pati dhe prodhimi i tullave dhe i tjegullave për nevojat e ndërtimit. Tjegullat e periudhës romake kanë vulën monograme "ΦΟΙΝΙΚΑ".

Gërmimet kanë zbuluar në Foinike disa ndërtime me karakter shoqëror: Nekropoli (vendvarrimi), Thesaurusi, Teatri i Finiqit, Bazilika në Akropol, Baptisteri, Piedestali i Neronit, Muri rrethues, një tempull kushtuar Athinasë, një gjimnaz, tri sterra uji të mëdha etj. Në çdonjërin prej tyre, pavarësisht fillesave të këtyre objekteve, gjenden gjurmë të ndikimit romak. Ndër to, dy sterrat e ujit janë të periudhës romake. Sterrat e mëdha dhe gjurmët e shumta të banesave në anët veriore dhe perëndimore të kodrës vërtetojnë popullsinë e dendur të Foinikes gjatë kësaj periudhe. Në akropol janë zbuluar shumë fragmente arkitektonike, si: shtylla me kanelyra së bashku me kapitete. Ndërtimet e tjera jashtë akropolit janë kryer me sistemin e tarracave e në përshtatje me terrenin e kodrës.

Nga zbulimet arkeologjike dallohet Banesa me dy peristile që ka planimetri katërkëndëshe. Qendra e kompozimit urbanistik të saj ka të bëjë me dy oborret me peristile A e B. Në banesë dallohen

qartë tri periudha kohore: *periudha e parë* i përket gjysmës së dytë të shek. III p.l.K.; *periudha e dytë* ajo romake e shek. I – III pas K., dallohet në bazë të qeramikës tipologjike të datueshme; *periudha e tretë* ajo e antikitetit të vonë shprehet në materialin e paktë të qeramikës dhe në traktin e murit të ndërtuar me llaç gëlqereje.

Foto e Teatrit Finiq

Teatri: Te teatri edhe pse i ndërtuar në shek. III p.l.K., dallohen mirë shkallaret, skena e vendi i orkestrës. Faqja ballore e proskenës formohej nga tri hyrje të zbukuruara me gjysma kolonash, të ndërtuara me tulla që tregojnë për një rindërtim të saj në periudhën romake. Teatri i Foinikes ka pasur një rreze pothuajse të barabartë me atë të teatrove të Apolonisë e të Bylisit. Specialistët mendojnë se teatri ka pasur një kapacitet prej 18 mijë spektatorësh.

Akropoli i Foinikes është më i madhi i botës klasike dhe muret e tij zgjaten në formë zig – zake deri në 2,5 km duke dalë kështu rreth 7 herë më të mëdhenj se ata të Athinës (Jacques 1988: 27). Nekropoli shtrihej në pjesën perëndimore e lindore të qytetit, në vendin e quajtur Matomar dhe i përket shekullit IV – III p.l.K.. Në to janë zbuluar shumë objekte e ornamente bizhuterie ari, objekte metalike, armë mes të cilave disa shpata të shkurta, si dhe monedha, pjesa dërrmuese e të cilave i takojnë periudhës kur Foinike figuronte si kryeqytet i Epirit. Disa prej tyre janë prej bronzi kanë në njërin faqe figurën e Zeusit të Dodonës, kurse disa të tjera mbajnë emrin e Foinikes që datojnë pas vitit 167 p.l.K..

Edhe gjatë sundimit romak, qyteti i Foinikes, vazhdoi të jetonte duke ruajtur karakterin autonom deri në shek. III pas K. kur kaloi një krizë të rëndë ekonomike dhe jeta humbi lulëzimin e saj.

4. Përfundim

Ndikimi romak në qytetet antike të Buthrotit dhe Foinikes të fisit Kaon ka nisur që në vitin 230 para K.. Nga analizat e materialit arkeologjik theksohen ndikimet romake dhe prania e elementit romak si në objektet arkeologjike (qeramikë, mbishkrime, monedha etj.), në

arkitekturë (teatrot, tempujt, vilat etj.) dhe në organizimin shoqëror dhe administrativ. Elementi romak ka qenë evident në disa aspekte në qytetet antike të Buthrotit dhe Foinikes. Kanë ndikuar në zhvillimin kulturor e historik të tyre duke i ruajtur gjurmët e tyre deri sot, por pa mundur të asimilojnë popullsinë e kulturën vendase.

Proceset ekonomike e politike që shoqëruan sundimin e gjatë romak, veç shkatërrimeve që sollën, patën edhe disa pasoja pozitive për popullsinë kaone e në tërësi epirote. Duke shembur format e vjetra të organizimit dhe duke vendosur administratën e tyre, pushtuesit romakë përshpejtuan procesin e shpërbërjes së formacioneve të vjetra fisnore. Trevat e banuara në Epir e Kaoni u ndanë në provinca, prefektura, dioqeza etj., të cilat përfshinë në territorin e tyre fise të ndryshme. Këto organizime shpënë në rrafshimin e dallimeve dhe shkrirjen e njësive të vogla fisnore në njësi më të mëdha në popujt dhe në kombësitë që u paraprinë kombeve moderne. Kështu, në përfundim të pushtimit romak, emrat e fiseve të lashtësisë, ua lanë vendin emrave të etnive të reja më të gjera.

Bibliografia

- ANAMALI, S. (1976), Buthroti në gjysmën e dytë të shek. I p.e.s. (ndodhet në *Almanak 2 Saranda/* sesion shkencor Sarandë.
- BUDINA, Dh. (1967), *Ujësjiellësi i Butrintit* S.H. 1967/2.
- CABANIS, P. (1974), Les inscriptions du theatre de Buthros: *Anales litteraires de l'Universitet de Besançon 163*.
- CAES, Bell, Civ III 40, 4.
- CEKA, H. (1998), *Rendi ekonomik në Epir*, Tiranë.
- CEKA, Neritan (2002), *Butrinti* Tiranë.
- DEDE, K. (1978), *Dhrrimadhes*, Himara.
- HODGES, R. (2006), *Album Butrinti i përjetshëm*.
- JACQUES, E. (1988), "N. Y. Times" 5 mars: libri *Shqiptarët*.
- LAKO, Kosta (1977 – 1978), *Gërmime në Butrint: Iliria VII-VIII*. Tiranë.
- LUKIANI (2007), *Vepra të zgjedhura*, Apioni Gal B5, Tiranë.
- MUSTILLI, D. (1940), *Gli Seavi italiani di Butrinto*, Roma. Pubblicazione Romana Anno IV nr. 4.
- PINDARI (2006), *Odwnemeane* II 51-3; te Richard Hodges *Album Butrinti i përjetshëm*" 2006.
- UGOLINI, L. M. (1942), *I Acropoli di Butrinto* Roma..